



UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 1298/1 Prot.

Durrës, më 08.09.2022

VENDIM

Nr 51, datë 08.09 2022

“Për miratimin paraprak të planit buxhetor afatmesëm, për periudhën 2023-2025, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës “

Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, zbatim të ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.02.2018 “Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit të përbashkët të MASR dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, Rregullores Financiare të Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës, Vendimit të Rektoratit nr.8, datë 03.06.2022, pika 5 , shkresës nr. 4692 prot., datë 13.07.2022 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Vendimit të Rektoratit nr. 11, datë 06.09.2022, relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Senati Akademik, në mbledhjen e datës 08.09.2022,

VENDOSI:

1. Miratimin paraprak të planit buxhetor afatmesëm, për periudhën 2023-2023, për Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës, sipas tabelave të Aneksit 7 A, bashkëngjitur .
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i përcillet për miratim përfundimtar Bordit të Administrimit.

KRYETARI SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Kseanela SOTIROFSKI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
ADMINISTRATORI
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT FINANCIAR

RELACION SHPJEGUES PËR PËRGATITJEN E PLANIT BUXHETOR
AFATMESËM (PBA) 2023 -2025,
PËR UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU", Durrës

I. *Projekt Buxhetit Afatmesëm 2023 – 2025 është hartuar në mbështetje dhe në zbatim të:*

1. Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"
2. Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"
3. Ligjit nr. 10296 datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"
4. Ligjit Nr.7703 datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republiken e Shqipërisë", i ndryshuar
5. Vendimit Nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të Këshillit të Ministrave
6. Vendimit nr. 158, datë 12.03.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", të Këshillit të Ministrave
7. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.545, datë 11.8.2011 "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave/Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", i ndryshuar me VKM 187 datë 08.03.2017.
8. Vendimit të KM nr.550, datë 11.08.2011 "Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar me VKM 268 datë 29.03.2017

9. Vendimit të KM nr.551, datë 11.08.2011 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.717, datë 23.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore", të ndryshuar me VKM nr.202 datë 15.03.2017
10. Vendimit nr. 329, datë 12.4.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", të Këshillit të Ministrave
11. Vendim nr. 75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", të Këshillit të Ministrave
12. Udhëzimit nr.29 datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet e arsimit të lartë"
13. Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm", të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë
14. Shkresës prot.nr., 4692 datë 13.07.2022 "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2023-2025", të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit
15. Formularëve standart të Aneksit 7-A. PBA 2023-2025 dërguar nga MAS sipas shkresës së sipërcituar
16. Vendimi nr. 30 datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës" të Bordit të Administrimit
17. Vendimi nr. 48 datë 22.06.2018 "Për disa ndryshime në miratimin e strukturës së përgjithshme dhe organikës analitike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës" të Bordit të Administrimit
18. Vendimit nr. 59 datë 24.07.2018 "Miratimin e niveleve të pagave të nëpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Bordit të Administrimit
19. Vendimit nr.50 datë 25.06.2021 "Për një shtesë në strukturën analitike të punonjësve buxhetorë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Bordit të Administrimit
20. Vendimit nr.34 datë 26.07.2022 " Për miratimin e pagesës së orëve mësimore të realizuar mbi mësimdhënien e normuar vjetore për vitin akademik 2021-2022, nga personeli akademik me kohë të plotë për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të Bordit të Administrimit
21. Vendimit të Rektoratit Nr.8, datë 03.06.2021, pika 5 "Ngarkimin e Dekanëve të Fakulteteve për përgatitjen e PBA 2023-2025 brenda datës 25.06.2022

22. Vendimit nr.95 datë 24.12.2021 "Për miratimin e hapjes së programit të ri si dhe të tarifës së programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve "Doktoratë" në "Pedagogji" pranë Departamentit të Pedagogjisë në Fakultetin e Edukimit, të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Bordit të Administrimit
23. Vendimit nr.13 datë 07.03.2022 të Senatit Akademik dhe Vendimit nr.11 date 11.03.2022 të Bordit të Administrimit "Për miratimin e kuotave të pranimit të studentëve në ciklin e parë të studimeve bachelor si dhe në programet e studimeve me karakter profesional (2 vjeçar), në ciklin e dytë të studimeve master i shkencave dhe profesional si dhe në ciklin e tretë të studimeve "Doktoratë", për vitin akademik 2022-2023 pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës
24. Vendimit nr. 35, datë 26.07.2022 të Bordit të Administrimit "Për përcaktimin e tarifave të shkollimit për studentët të cilët do të regjistrohen për herë të parë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në vitin akademik 2022-2023".
25. Vendimit nr. 36, datë 26.07.2022 të Bordit të Administrimit "Për përcaktimin e tarifave të studimit për studentët të cilët janë regjistruar për herë të parë në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në vitin akademik 2022-2023"
26. Urdhërit nr. 468 datë 02.08.2022 "Për financimin/bashkëfinancimin e projekteve të përbashkëta në kuadër të ndërkombëtarizimit të programeve të studimit, për vitin akademik 2022-2023", të MAS, përcjellë me shkresën prot.nr., 5164/1 datë 02.08.2022 nga MAS
27. Propozimeve të përcjella nga Fakulteti i Studimeve Profesionale përcjellë në shkresën prot.nr., 1038/1 datë 01.07.2022, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit përcjellë në shkresën prot.nr., 1033/2 datë 15.07.2022, Fakulteti i Biznesit me shkresën prot.nr., 1038 datë 28.06.2022, Drejtoria e Projekteve dhe Marrëdhënieve me Jashtë përcjellë me shkresën prot.nr., 1187 datë 01.08.2022, për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm, për periudhën 2023-2025, kërkesave buxhetore të paraqitura në hartimin e buxhetit, ecurinë e të ardhurave e shpenzimeve për tre vitet akademike paraardhëse dhe të dhënave statistikore të përcjella nga Sektori i Statistikave dhe Alumni.

II. Objektivat të cilat priten të realizohen janë në mbështetje të objektivave të Programit Buxhetor Afatmesëm të Qeverisë Shqiptare dhe përmbushjen e misionit të Institucionit tonë në fushën e arsimit. Konkretisht si më poshtë :

- Institucioni ynë në gjithë veprimtarinë e tij ka si objektiv dhe synon në mënyrë të vazhdueshme të përmirësojë standardet akademike si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arritjet e cilitdo që kërkon të përfitojë nga arsimi i lartë
- Synohet të kemi rritje të numrit të studentëve të cilët regjistrohen për herë të parë në tre cikle studimi.
- Synohet hapja e programeve të reja të studimit në të treja ciklet e studimeve në përshtatje me profilet dhe kërkesat e tregut të punës
- Synojmë të diplomojmë një numër më të madh studentesh në të dyja ciklet e studimeve
- Përmirësim në infrastrukturën e godinave si dhe rritja e kapaciteteve pritëse nëpërmjet ndërtimit të një godine të re për Fakultetin e Studimeve Profesionale.
- Përmirësim i laboratorëve dhe ndërtimi i një laboratorit për programin "Ndihmës dentist" për programet e Fakultetit të Studimet Profesionale.
- Mbështetja e kërkimit shkencor dhe aktiviteteve shkencore, të veprimtarive krijuese, ofrimin e shërbimeve dhe ushtrimin e veprimtarive të tjera, në përputhje me fushat e programeve të studimit, me ligjin e arsimit të lartë dhe me statutin e Institucionit.

III. HARTIMI I SHPENZIMEVE FUNKSIONALE TË PBA 2023-2025

Totali i shpenzimeve të paraqitura në Projekt Buxhetin Afatmesëm (2023-2025), për vitin 2023, për Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës, paraqitet me një vlerë prej 1 617 229 000 lekë, nga të cilat 1 390 360 000 lekë (ose 86 %) të financuara nga buxheti i shtetit dhe 226 869 000 lekë (ose 14 %) të financuara nga të ardhurat.

Kërkesa për vitin 2023 është hartuar në dy programe. Programi 09450 (programi i shpenzimeve për funksionimin e përditshëm) dhe programi 09970 "shpenzime për kërkimin shkencor".

Kërkesa totale në programin 09450 është në vlerën prej 1 538 229 000 lekësh dhe kërkesa në programin 09770 është në vlerën prej 79 000 000 lekësh.

Treguesit kryesor të cilet kane impakt te drejtperdrejte ne hartimin e buxhetit jane numri i studentëve dhe numri i punonjësve- Keto tregues janë parashikuar në rritje te lehte për vitin 2023.

Kerkesa per buxhetin e parashikuar per vitin 2023 paraqitet pothuajse në të njëjtat nivele me kerkesen buxheore të parashikuar për vitin 2023.

Shpenzimet e parashikuara nga të ardhurat për vitin 2023 janë parashikuar me rritje te lehte ne krahasim me shpenzimet e pritshme per vitin 2022.

Per sa i perket shpenzimeve të cilat parashikohet te financohen nga granti i vitit 2023 ne krahasim me vitin 2022 paraqiten me te rritura ne vleren 533 874 000 leke.

Kërkesa në rritje për financim nga buxheti per vitin 2023 paraqiten në zërat shpenzime për personelin, shpenzime për bursa, shpenzime per projekte kerkimore dhe shpenzime për investime Gjithashtu për vitin 2023 parashikohet një rritje e numrit të punonjësve me kohë të plotë sipas kërkeses se paraqitur nga FSP –së për personel akademik.

Për vitin 2023 është parashikuar që shpenzimet për personelin me kohë të plotë, (paga + orë mësimore suplementare + sigurime), shpenzimet per personelin me kohe te pjesshme, shpenzimet per bursa te financohen në masën 100% nga granti i vitit 2023, ndersa shpenzimet per blerje mallrash dhe sherbimesh per funksionimin e perditshem te financohen në masën 72 nga granti dhe 28 % nga te ardhurat.

Kërkesa buxhetore e parashikuar për vitin 2023 dhe krahasimi i saj me realizimin e pritshem per vitin 2022 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Tabela nr. 1

ne 000 leke

Financimi	VITI 2022		VITI 2023 (parashikimi)	
	Realizimi i pritshëm me financim nga grant + buxhet per vitin 2022	Realizimi i pritshëm me financim nga te ardhurat e vitit 2022	Financimi i parashikuar nga granti dhe buxheti 2023	Financimi i parashikuar nga te ardhurat 2023
Lloji i shpenzimit				
Shpenzime per paga	610 029	31 926	688,255	0
Shpenzime per sig shoqerore	95 000	20 463	106,051	0
Shpenzime per blerje mallrash dhe sherbime per programin 09450	60 000	34 821	76,054	29,570
Shpenzime per bursa dhe rimbursim tarifa	76 140	3 000	80,000	0
Shpenzime per investime	10 000	271 983	380 000	178 299

Shpenzime per kerkimin shkencor (programi 09770)	5 317	46,397	60 000	19,000
TOTAL	856 486	408 590	1 390 360	226 869

1. Hartimi i artikullit "të ardhura" ne PBA 2023-2025.

Në këtë artikull janë përfshirë të gjitha të ardhurat me natyrë jo tatimore që mund të arketojë Institucioni ynë në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Llogaritja e të ardhurave është bërë në përputhje me Ligjin 80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kerkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit nr. 35 dhe nr. 36, datë 29.07.2022 të Bordit të Administrimit, për përcaktimin e tarifave të shkollimit për studentët të cilët do të regjistrohen për herë të parë në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ose në ciklin e dytë pranë Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, në vitin akademik 2022.-2023.

Të ardhurat e pritshme për vitin 2023 paraqiten në vlerën 256 988 000 lekë nga të cilat:

- 228 399 000 lekë parashikohet të arkëtohen nga tarifat e shkollimit,
- 6 670 000 lekë nga tarifat e regjistrimit
- 16 919 000 lekë tarifa diplomi dhe shërbime të tjera
- 5 000 000 lekë sponsorizime të realizuara nga DESTIP

Në total të ardhurat e pritshme për t'u realizuar për vitin 2023 paraqiten 28 674 lekë më rritura nga parashikimi për vitin 2022. Kjo shpjegohet me faktin se është parashikuar një rritje e lehtë e numrit të studentëve në të tre ciklet e studimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet i detajuar nr i studentëve për vitin akademik 2021-2022 dhe 2022-2023 sipas cikleve të studimit

Tabela nr 2

Numri i studentëve për vitin 2021-2022 me Kohë të Plotë +Kohë të pjesshme

Nr.	IAL	Numri i Studentëve me kohë të plotë					Doktoraturë	Gjithsej me Kohë të Plotë	Gjithsej me Kohë të pjesshme	TOTALI
		BA	PIND	2-vjeçare	MSH	MP				
1	Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	10350	490	2788	2265	1831	16	17740	1359	19 099

Tabela nr. 3

Numri i studentëve për vitin 2022-2023 me Kohë të Plote +Kohë të pjesshme

IAL Publik	Numri i Studentëve me kohë të plotë					Doktoraturë	Gjithsej me Kohë të Plotë	Gjithsej me Kohë të pjesshme	TOTALI
	BA	PIND	2-vjeçare	MSH	MP				
Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës	9798	700	3430	2310	1750	34	18 022	1300	19 322

Perlllogaritjet mbi pritshmëritë për numrin e studentëve, për të treja ciklet e studimit për vitin akademik 2022 - 2023 si dhe të ardhurat e pritshme për vitin 2023, janë bërë duke marrë në konsideratë trendin e regjistrimeve, cregjistrimeve dhe diplomimet në tre ciklet për tre vitet akademike pararendëse.

Mbeshtetur në këtë trend mbi numrin e studentëve që regjistrohen për herë të parë në ciklin e parë dhe në ciklin e dytë të studimeve, numrin e studenteve që diplomohen, numrin e studenteve që cregjistrohen, tarifat e shkollimit të miratuara për të dyja ciklet, është hartuar perlllogaritja e numrit të studenteve që parashikohet të frekuentojnë studimet në vitin akademik, 2022 -2023 dhe 2023-2024 si dhe të ardhurat e pritshme për t'u realizuar gjatë vitit 2023, 2024 dhe 2025.

Numri i studenteve të ciklit të parë të cilët parashikohen për vitin 2022-2023 paraqiten më të rritur me rreth 300 studentë dhe të ardhurat e pritshme parashikohen me një rritje prej 2 577 000 lekësh. Në perlllogaritjen e të ardhurave që pritet të arkëtohen në vitin 2023 janë marrë në konsideratë edhe efektet financiare të studenteve të cilët paguajnë 50% të tarifës së shkollimit pasi rezultojnë më notë mesatare mbi 6, studentët të cilët janë jashtë kohës normale të studimit, studentët të cilët nuk vijnë rregullisht procesin mësimor si dhe numri i studentëve të cilët paguajnë tarifë zero.

Për vitin akademik 2022 - 2023, parashikohen rreth 10 702 studentë të cilët janë kohës normale të studimit (për të dyja ciklet) Në këtë perlllogaritje nuk janë marrë në konsideratë numri i studentëve të cilët kanë mbushur dyfishin e kohës normale të ciklit të studimit, dhe në mbështetje të ligjit 80/2015 datë 22.07.2015 duhet të cregjistrohen. Gjithashtu për vitin akademik 2021-2022 parashikohet që 3 770 studentë të viteve të para, dyta dhe të treta të paguajnë 50% të tarifës së shkollimit dhe 950 studentë janë të perjashtuar nga detyrimi për të paguar tarifen e shkollimit pasi vijnë nga kategori në nevojë ose janë studentë të shkëlqyer. (referuar të dhënave të vitit akademik 2021 – 2022).

Në perlllogaritjen e të ardhurave nga tarifa e shkollimit për ciklin e dytë të studimit nuk janë llogaritur të ardhura të pritshme nga studentët të cilët janë jashtë kohës normale të studimit pasi ata nuk paguajnë tarifë shkollimi.

Tarifat e studimit për ciklin e parë dhe të dytë për vitin akademik 2021-2022 dhe 2021 -2022 nuk kanë pësuar ndryshime

Për sa i përket numrit të studentëve të ciklit të tretë janë parashikuar të regjistrohen për herë të parë në vitin akademik 2022 -2023 edhe 18 studentë doktorantë.

2. Përdorimi i të ardhurave të parashikuara për vitin 2023.

Për vitin 2023 parashikohet që nga të ardhurat e realizuara 78.5 % e tyre të përdoret për shpenzime për investime, 8.3 % për financimin e kerkimit shkencor dhe 13.2% për shpenzime për blerjen e mallrash dhe shërbimesh për funksionimin e perdritshëm. Në shpenzimet për investime të planifikuara për t'u financuar nga të ardhurat janë përfshirë shpenzimet për investime të reja si laboratorë të rinj, përmirësimi i laboratorëve ekzistues si dhe përmirësim në infrastrukturë.

3. Për hartimin e PBA në artikullin "Shpenzime personeli (artikulli 600 + 601)"

Shpenzimet për personelin (shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore) janë përlllogaritur duke marrë në analizë sipas kategorive përkatëse numrin total të punonjësve organikë brenda strukturës së miratuar të Universitetit, dhe referuar:

- Ligjit Nr.7703 datë 11.5.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
- Vendimit Nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", të Këshillit të Ministrave,
- Vendimit të KM nr.550, datë 11.08.2011 "Për disa ndryshime në vendimin nr.748, datë 11.6.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", të ndryshuar me VKM 268 datë 29.03.2017
- Vendimit nr. 30 datë 31.05.2018 "Për miratimin e strukturës së përgjithshme të Universitetit Aleksandër Moisiu", Durrës" të Bordit të Administrimit",
- Vendimit nr. 48 datë 22.06.2018 "Për disa ndryshime në miratimin e strukturës së përgjithshme dhe organikës analitike të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës" të Bordit të Administrimit
- Vendimit nr. 59 datë 24.07.2018 "Miratimin e niveleve të pagave të nënpunësve të administratës dhe punonjësve mbështetës të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Bordit të Administrimit

- Vendimit nr.50 datë 25.06.2021 "Për një shtesë në strukturën analitike të punonjësve buxhetorë të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës, të Bordit të Administrimit
- Vendimit nr.34 datë 26.07.2022 " Për miratimin e pagesës së orëve mësimore të realizuar mbi mësimdhënien e normuar vjetore për vitin akademik 2021-2022, nga personeli akademik me kohë të plotë për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të Bordit të Administrimit
- Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Për Kodin e Punës në Republikën e Shqipërisë". Paga bazë minimale mujore jepet për 174 (njëqind e shtatëdhjetë e katër) orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 183.9 ((njëqind e tetëdhjetë e tre pikë nëntë) lekë si dhe shtesat me karakter të përhershëm jepen mbi pagën bazë. Pagat dhe shtesat janë paraqitur në nivelin mujor.
- Vendimit nr. 158, datë 12.03.2022 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", të Këshillit të Ministrave

Në përlllogaritjen e kërkesës mbi numrin e përgjithshëm të punonjësve organikë (personel me kohë të plotë, për vitin buxhetor 2023 është punuar duke respektuar strukturën e personelit të miratuar për vitin buxhetor 2022 si dhe kërkesat a paraqitura nga fakultetet për nevoja shtese në numrin e personelit akademik. Numri i punonjësve brënda strukturës organike të miratuar për vitin 2022 është 554 ndersa për vitin 2023 parashikohet të jetë 575 punonjës me kohë të plotë nga të cilët 336 personel akademik dhe 239 personel administrativ dhe akademik me karakter ndihmës akademik. Shtesa prej 21 punonjësish për vitin 2023 perfshin kërkesen e paraqitur nga Fakulteti i Studimeve Profesionale për shtim të personelit akademik me kohë të plotë. Ne vitin 2023 ne krahasim me vitin 2022 numri i personelit akademik të angazhuar me kohë të pjesshme nuk parashikohet të ketë ndryshime. Kjo lidhet me faktin se nuk parashikohet të ketë ndryshime të ndjeshme në numrin e përgjithshëm të studentëve në të dyja ciklet e studimit për vitin akademik 2022-2023.

Numri i lektorëve me kohë të pjesshme, për vitin akademik 2021 – 2022 rezulton rreth 354 lektore dhe shpenzimet e pritshme parashikohen në vlerën rreth 28 160 000 lekë. Për vitin akademik 2022 – 2023 shpenzimet për personelin akademik me kohë të pjesshme janë planifikuar rreth 31 896 000 leke. Parashikohet të angazhohet i njëjti numër lektorësh rreth 354 lektore me kohë të pjesshme.

Nqs do të analizojme raportin student/lektor (personel me kohë të plotë + personel me kohë të pjesshme) ky tregues rezulton në standartin 28 student / lektor. Angazhimi i lektorëve me kohë të pjesshme përmirëson raportin student/lektor. Ky është një tregues shume optimal mbi cilësinë dhe kushtet e mësimdhënies. Për këtë arsye nuk planifikohet rritje e ndjeshme e numrit të personelit akademik me kohë të plotë dhe angazhimi në të njëjtin nivel i numrit të personelit akademik me kohë të pjesshme.


Totali i shpenzimeve për paga për vitin 2023 për personelin me kohë të plotë dhe të pjesshme paraqitet në vlerën 688 254 663 lekë ose 46 299 960 lekë më shumë sesa shpenzimet e pritshme për vitin 2022. Ato do të financohen në masën 100% nga buxheti.

Shpenzimet për paga për vitin 2023 përfshijnë:

- 580 833 183 lekë shpenzime për paga për personelin me kohë të plotë
- 75 525 000 lekë shpenzime për orë mësimore suplementare të realizuara mbi normën vjetore për vitin akademik 2022 – 2023
- 31 896 480 lekë shpenzime për personelin akademik me kohë të pjesshme

Sic e përmendëm edhe më lart "shpenzime për personelin" parashikohet të financohen nga buxheti i shtetit.

Në zërin shpenzime për paga është përfshirë dhe fondi i vecantë.



4. Për hartimin e buxhetit në zërin e shpenzimeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore.

Në hartimin e shpenzimeve në këtë artikull është zbatuar Ligji nr.10070, datë 05.02.2009 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", masa e kontributit për sigurimet shoqërore që paguhet nga punëdhënësi është 15% plus 1.7 % masa e kontributit nga punëdhënësi për sigurimet shëndetësore, gjithsej 16.7%, në kufijtë e pagës minimale dhe maksimale.

Përlllogaritjet fondit "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" janë realizuar mbështetur në Vendimin nr. 77, datë 28.1.2015 të

Këshillit të Ministrave "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor" të ndryshuar, ku përcaktohet:

Për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore, paga bruto mujore, do të jetë jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me 32 000 lekë dhe deri në 141 133 lekë, për personat e punësuar.

Për të punësuarit, marrëdhëniet e punës të të cilëve regullohen në baze të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, paga minimale mujore, për llogaritjen e kontributeve, është ajo e përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në zbatim të nenit nr.111, të ligjit të sipërpërmendur. Bazuar në Ligjin nr.10070, datë 05.02.2009 "Për disa ndryshime në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" masa e kontributit për sigurimet shoqërore që paguhet nga punëdhënësi është gjithsej 16.7% (15% + 1.7 %) masa e kontributit nga punëdhënësi për sigurimet shëndetsore brenda kufijve të pagës minimale dhe maksimale.

Shpenzimet për sigurime shoqërore për vitin 2023 parashikohet të jenë në vlerën 106 051 109 lekë. Këto shpenzime do të financohen në masën 100% nga buxheti.

5. Pasqyra e numrit të punonjësve.

Në këtë pasqyrë raportuar numri i punonjësve të miratuar për vitin 2021, i pritshmi i vitit 2022 si dhe parashikimi për vitin 2023 duke i paraqitur, sipas numrit të punonjësve të miratuar në strukturën organike të miratuar si dhe numri i punonjësve me kontratë ku perfshihet personeli akademik i emëruar me kohë të pjesshme.

Për sa i përket parashikimit mbi numrit të punonjësve me kohë të plotë dhe të pjesshme për vitin 2023 është bërë duke marrë në konsideratë numrin mesatar të punonjësve për vitin 2022.

Numri i punonjësve me kohë të plotë është miratuar me Vendim nr. 30, datë 31.05.2018 të Bordit të Administrimit "Mbi miratimin e strukturës të përgjithshme të Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës", të ndryshuar me vendim nr. 48, datë 22.06.2018, vendim nr. 65, datë 27.09.2018, vendim nr. 22, datë 31.05.2019, vendim nr 50, datë 25.06.2021, të Bordit të Administrimit.

Numri i punonjësve me kohë të plotë për vitin 2022 parashikohet në 575 punonjës nga të cilët 339 janë punonjës akademik dhe 236 janë personel administrativ dhe ndihës akademik.

Planifikimi i numrit të punonjësve, është mbështetur në numrin e personelit të miratuar për vitin 2022, strukturën analitike, udhëzimet për normat mësimore shkencore, ndryshimet e pritshme për vitin 2021-2022 dhe 2022 – 2023 si rezultat i shtimit/pakësimit të numrit studentëve në mbështetje të kuotave të miratuara dhe objektivave për zhvillimet e pritshme të Institucionit tonë, kërkesave të

paraqitura nga çdo njësi kryesore e UAMD.

Për vitin 2023 parashikohen të janë 354 punonjës më kontratë të përkohëshme (personel akademik të angazhuar me kohë të pjesshme). Numrit i lektorëve me kohë të pjesshme paraqitet pothuajse në të njëjtin nivel pasi nuk parashikohet rritje e ndjeshme e numrit të studentëve.

6.. Për hartimin e PBA në artikullin "Shpenzime për blerje mallrash dhe shërbime për funksionimin e perdritshëm"

Hartimi i kërkesave 2023-2025 në zërin "Mallra dhe shërbime" është realizuar në mbështetje të "Manualit për Klasifikimin Ekonomik të Shpenzimeve", të Ministrisë së Financave, kërkesave për mallra dhe shërbime të paraqitura nga fakultetet si dhe nga drejtuesit e strukurave të tjera administrative në UAMD, shpenzimet periodike vjetore për energji, ujë, shërbim postar, pagesa për komisione, mirëmbajtje pajisje teknike, mirëmbajtje orendi dhe pajisje zyre etj

Hartimi i kërkesës për buxhet në këtë artikull, për vitin 2023, është mbështetur në treguesit analitikë të shpenzimeve faktike të vitit 2021, shpenzimet e pritshme për vitin 2022, si dhe kërkesat e parashikuara për vitin 2023.

Hartimi i PBA 2023 - 2025 në këtë artikull ka lidhje të drejtpërdrejtë me realizimin e pritshëm të buxhetit për vitin 2022, për të gjitha shpenzimet e parashikuara për mallra dhe shërbime, të miratuara në regjistrin e parashikimit të prokurimeve publike.

Në hartimin e kërkesës për shpenzime sipas artikujve të këtij zëri jemi mbështetur në kërkesat për blerje të domosdoshme për funksionimin normal të institucionit dhe në kërkesat e paraqitura për financimin e veprimtarive mësimore – shkencore dhe veprimtari studentore.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur në mënyrë të përmblëdhur shpenzime operative për vitin 2021 – 2025 si dhe burimi i financimit.

Tabela nr. 4

	FAKTI 2021		I PRITSHMI VITI 2022		PARASHIKIMI VITI 2023		VITI 2024	VITI 2025
	Financimi nga granti	Financimi nga te ardhurat	Financimi i pritshëm nga granti	Financimi i pritshëm nga te ardhurat	Financimi i parashikuar nga granti	Financimi i parashikuar nga te ardhurat	Kërkesa	Kërkesa
Emertesa								
Materiale zyre dhe të përgjithshme	5.062	115	5.253	468	7.300	0	7.300	7.300
Materiale dhe shërbime speciale	0	1.592	1.199	1.492	800	2.492	3.292	3.292

Sherbime nga te trete	31.313	8.719	36.515	15.556	48.354	7.393	55.747	55.747
Shpenzime transporti	40	285	5	3.800	0	5.185	5.185	5.185
Shpenzime udhetimi	0	580	1.500	2.500	4.000	0	4.000	4.000
Shpenzime per mirembajtje te zakonshme	0	4.281	0	4.924	0	8.500	5.500	8.500
Shpenzime per qeramarrje	-	-	-	-	-	-	-	-
Shpenzime per detyrime dhe kompensime legale	546	125	0	0	0	0	0	0
Shpenzime per kuota anetaresimi	383	0	600	0	600	0	600	600
Shpenzime te tjera operative	12.105	9.720	15.464	5.545	15.000	6.000	21.000	21.000
TOTAL	49.449	25.417	60.536	34.285	76.054	29.570	102.624	105.624

Siç shikohet edhe nga tabela shpenzimet e parashikuara në zërin shpenzime per blerje mallra dhe sherbimesh per vitin 2023 paraqiten më të rritura ne vleren 10 803 000 leke ne krahasim me realizmin e pritshëm te vitit 2022. Në aneksin 7A paraqiten në mënyrë analitike zërat e shpenzimeve.

Ne kete ze shpenzimesh jane te perfshira blerje mallrash si materiale dhe sherbime per financimin e aktiviteteteve shkencore per vitin 2023.

7. "Shpenzime per blerje mallrash dhe sherbime per kerkimin shkencor, kerkimin shkencor.

Per vitin 2023, ky ze eshte hartuar duke u mbeshtetur ne:

Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 75, datë 12.2.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të Arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", Udhëzimin nr 20, datë 20.09.2019 për skemen e financimit të IAL-ve", shkresa nr. 5164/1 datë 02.08.2022 e MASR "Njoftim për projektet e miratuara për vitin 2022-2023" si dhe realizmin e pritshëm për vitin 2022. .

Shpenzimet e planifikuara për blerje mallrash dhe sherbime per kerkimin shkencor jane ne vleren 79 000 leke dhe do te financohen në vlerën 60 000 000 lekë nga granti i miratuar sipas shkresës së sipërcituar dhe 19 000 000 nga të ardhurat. Financimi nga të ardhurat është hartuar duke marrë në konsideratë fondin e miratuar për vitin 2022 ku përfshihen pagesat për botimet shkencore në revista me faktor impakti, bashkëfinancim në projektet e huaja si dhe financimi i projekteve kërkimore të shpallura fituese nga UAMD. .

8. Per hartimin e kërkesave ne artikullin " Bursat e studenteve dhe te tjera transferta tek individet" (artikulli 606).

- Hartimi buxhetit në këtë artikull pasqyron kërkesat e institucionit për bursa per trajtimin me bursë financiare për studentet e ciklit të parë. Numri i studentëve që parashikohet të trajtohen me bursë dhe shpenzimet për to janë realizuar mbështetur në numrin e studentëve që trajtohem me bursë për vitin 2021-2022. Numri i studentëve që trajtohen me bursë paraqiten me rritje nga 808 studentë në 860 studentë për vitin akademik 2022-2023, duke pare trendin ne rritje per cdo vit akademik dhe pritshmerine ne rritje te numrit te studenteve. Kërkesa per financim ne zerin shpenzime per bursa per vitin 2023 paraqitet ne vleren 80 000 000 leke. Në kategorinë e studentëve të cilët trajtohen me bursë janë studentë të shkeëlqyer studentët që vijnë nga kategori në nevojë. Shpenzimet per bursa financohen ne masen 100% nga buxheti.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet numri i studentëve dhe fondi i bursave për katër vite akademike

9.. Per hartimin e PBA ne artikullin "Shpenzime per rritjen e aktiveve te qendrueshme".

Shpenzimet e planifikuara në këtë zë paraqiten në programi 09450.

Totali i shpenzimeve për investime të parashikuara për vitin 2023 paraqitet në vlerën 558 299 000 lekë të financuara në vlerën 350 000 000 lekë ose 63 % nga buxheti dhe 155 000 000 nga të ardhurat.

Shpenzimet për investime janë hartuar duke marrë në konsideratë kërkesat e paraqitura nga Fakulteti i Studimeve Profesionale dhe Fakulteti i Teknologji Informacioni për ndërtim dhe përmirësim si dhe përmirësime në infrastrukturën fizike për zbatimin e projekteve ndërtimore të hartuara gjatë vitit 2022.

Investimi më i rëndësishëm për vitin 2023 është zbatimi i projektit për ndërtimin e godinës së për Fakultetin e Studimeve Profesionale në kampusin e ri. Ky investim parashikohet të financohet nga buxheti i shteti si dhe nga të ardhurat tona.

Për këtë arsye është planifikuarqë pjesa më e madhe e të ardhurave të përdoren në zërin "innestime" dhe shpenzimet e tjera të financohen nga granti i vitit 2023.

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të listuara shpenzimet për investime si burimi i tyre i financimit:

Tabela nr. 5

INVESTIME TE PARASHIKUARA PER VITIN 2023

(ne 000 leke)

Grupi	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i Degese Thesarit	Emertimi i projektit te investimit	KerkesaProjektbuxheti 2023	Parashikimi për vitin 2024	Parashikimi për vitin 2025
11	06	09450	2310000	707	Blerje pajisje per laboratorin e programit specialist sisteme kondicionimi	816		
11	06	09450	2310000	707	Blerje pajisje per permiresimin e laboratorit Teknik elektrik	4,744		
11	06	09450	2310000	707	Blerje pajisje per kliniken dentare prane UAMD	800		
11	06	09450	2310000	707	Blerje pajisje per permiresimin e laboratorit biologji - kimi	5,458		
11	06	09450	2310000	707	Blerje pajisje per permiresimin e laboratorit te fizikes	481		
11	06	09450	2310000	707	Blerje pajisje per labororet per programet dy vjecare te FTI	1,000	0	
11	06	09450	2310000	707	Punime ndertimore per "Ndertimin e godines se FSP-se " ne kampus	150,000	134,100	
11	1	09450	2310000	707		350,000	311,000	
11	06	09450	2310000	707	Punime ndertimore per rikonstruksionin e godines ne Curila dhe godines nr. 1 ne kampus	10,000		
11	1	09450	2310000	707		30,000		
11	6	09451	2310000	707	Supervizim dhe kolaudim punimesh ndertimoe	5,000	5,000	
					TOTALI	558.299	450,100	0
					Financimi nga buxheti	380,000	311,000	-
					Financimi nga te ardhurat	178,299	139,100	-

DREJT. DREJTORISË SË ADMINISTRIMIT FINANCIAR

ETLEVA LAÇI

